

08.04.2022
Ora 12:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**
- **Të tjerë:** **Z. Kristaq Kume, Z. Mentor Kikia,
Znj. L. Hoxha**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën publike të ditës së sotme, e cila ka në rend dite vetëm një çështje, e cila lidhet me miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, paraqitur kjo nga disa organizata të shoqërisë civile. Bëjmë një relativim nga ana e sekretarit fillimisht, pastaj i japim fjalën përfaqësuesve dhe të interesuarve për këtë nismë.

Z. Y. Merkaj: Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, Qendra për Progres Rinor – Kukës, Shoqata “Hapa të Lehtë” – Shkodër, Shoqata “Komuniteti

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

Malazes në Shqipëri” – Elbasan, Qendra “Tamara” – Tiranë, Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës, Forumi “Mendimi i Lirë”, dhe Shoqata “Zëri Qytetar” – Lushnjë, kanë paraqitur kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””. Bashkëlidhur kërkesës, komiteti përfaqësues ka depozituar:

- Kopje të kartave të identitetit të përfaqësuesve të nismës;
- Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe,
- Relacionin shpjegues të projektligjit.

Projektligji që do t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka për qëllim përmirësimin e demokracisë përfaqësuese në pushtetin vendor me objektiv rritjen e cilësive në administrimin e punëve vendore dhe shërbimeve për komunitetin. Në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të ligjit “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërën anë duhet të përmbajë informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër duhet të përmbajë: numrin rendor, të dhënat e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve. Referuar nenit 19, pika 1, të ligjit “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përcakton me vendim periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve. Referuar kërkesës, periudha për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të kësaj nisme ligjvënëse, do të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Bashkëlidhur keni vendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelin tip të mbledhjes së nënshkrimeve, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! I japim fjalën përfaqësuesit të Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemeve Zgjedhore, zotit Kristaq Kume, për të prezantuar në emër të institutit, po dhe të organizatave të tjera besoj, nismën. Faleminderit zoti Kume!

Z. K. Kume: Faleminderit! Nisma që ne kemi bërë kërkesën për ta analizuar, në zbatim dhe mbështetur në atë ç'ka na lejon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës 20 mijë zgjedhës kanë të drejtën për të propozuar një projektligj në Kuvendin e Shqipërisë dhe ligjit përkatës pastaj për të. Kjo nismë është rezultat i punës së bërë nga tetë organizata të shoqërisë civile, të mbështetura nga "Lëviz Albania" dhe Ambasada e Zvicrës e cila ka pasur dhe ka në fokus të saj problemet e mirëqeverisjes së komuniteteve lokale dhe trajtimit të mundësive të rrugëve ligjore të cilat mund t'i shërbejnë rritjes së mëtejshme të cilësisë së përfaqësimit të qytetarëve në organet që zgjidhen për qeverisjen vendore. Këtu kemi parasysh këshillin e njësisë vendore. Nisma ligjvënëse, e cila në fakt është një projektligj për të amenduar Kodin Zgjedhor, dispozitat në të cilat trajtohen problemet e zgjedhjes së organeve të qeverisjes vendore. Është formësuar si e tillë si rezultat i një pune intensive, një proces intensiv marrje mendimesh, opinionesh, konsultimesh. Konsultime me qytetarët në bashki të ndryshme të vendit. Konsultime me të zgjedhurit vendorë anëtarë të këshillave bashkiakë, në rreth 11 bashki të vendit, me


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, banorë të zonave urbane dhe atyre rurale, me përfaqësues të pakicave kombëtare dhe grupeve të tjera të markenalizuara, nqs mund t'i quajmë si të tillë. Po ashtu pas një procesi intensiv studimi, analize të legjislacionit aktual që trajton probleme të vetqeverisjes vendore pra, jo vetëm të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, por dhe informacionit i cili u grumbullua nga partnerët në këtë projekt gjatë intervistimeve ballë për ballë të bërë me zgjedhës me shpërndarje të gjerë në territor, duke i kushtuar vëmendje të veçantë komuniteteve në zonat rurale. Pjesë të këtij procesi konsultimi me vëmendje të shtuar nga ne, kanë qenë dhe komunitetet, stafet akademike në universitetet e vendit. Si rezultat i gjithë kësaj pune, grupi i ekspertëve tanë, arriti të hedhë në letër opsione të ndryshme se si mund të ndërhyhet në legjislacion për të realizuar atë objektiv që thashë pak më parë. Duke paraqitur këto opsione të cilat edhe këto iu nënshtruan një procesi intensiv konsultimi për të gjetur atë që do të kishte dakordësinë sa më të madhe. Rezultati i saj është drafti/projekti që ne kemi paraqitur dhe që kërkojmë si të tillë për ta nisur në Kuvendin e Shqipërisë, si nismë ligjvënëse qytetare. Dy janë momentet më të rëndësishme që ne mendojmë se, në qoftë se Kuvendi i Shqipërisë do t'i miratojë si të tilla në kuadër të reformës për Kodin Zgjedhor, që do të kenë efekte pozitive në rritjen e cilësisë së përfaqësimit të qytetarëve në këshillat e njësisive vendore. E para është, propozimi që ne do të bëjmë dhe po paraqesim në Kuvend për të ndryshuar, për të ndërhyrë në sistem sipas së cilës zgjidhen këshilltarët. Nga një sistem proporcional me lista të mbyllura, në një sistem proporcional me lista të hapura, ku qytetarëve zgjedhës t'u jepet e drejta që të përdorin votën parapëlqyese për një nga kandidatët e listës. Për ta bërë pastaj efektive përdorimin e votës parapëlqyese në realizimin e parimit shumë të kërkuar të përfaqësimit proporcional të komuniteteve të ndryshme në organin e zgjedhur. Ne parashikojmë që në Kodin Zgjedhor të vendoset kushti për partitë politike, të cilat në zbatim të tij të hartojnë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

listat e kandidatëve me përfaqësues në të, të gjithë komuniteteve që bëjnë sens, që kanë peshë në bashkinë përkatëse. Kjo do të thotë që mundësia që do të kenë komunitetet e caktuara për të dërguar në këshillin bashkiak përfaqësuesin e tyre, në këtë mënyrë do të jetë reale, sepse do të kenë për kë të japin votën e tyre parapëlqyese. E rëndësishme është që zgjidhja që ne i kemi dhënë problemit në draft, për mënyrën se si do të përdoret vota parapëlqyese është e ndryshme nga ajo që parashikohet sot në Kodin Zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë. Sipas saj ndarja e mandateve që fiton një subjekt zgjedhor do të bëhet midis kandidatëve të subjektit, pasi ata të rirenditen mbështetur në votat parapëlqyese. Në këtë mënyrë ne mendojmë se do të krijojmë kushtin e nevojshëm ligjor për të mos pasur më të përsëritura ato situata me të cilat është ndeshur deri më sot dhe veçanërisht pas reformës së fundit në pushtetin vendor, qeverisja vendore, këshillat e njësive vendore në të cilat ka komunitete të tëra, veçanërisht komunitetet rurale që nuk kanë fare përfaqësues të tyre në këto këshilla. Si pasojë edhe cilësia e shërbimeve që u ofrohet këtyre të ndikohet negativisht. Kjo është ajo që ne synojmë të realizojmë, ju falenderojmë ju, që kërkesës sonë ju përgjigjët në kohë dhe shpresojmë që së bashku do t'ia arrijmë asaj që ne kemi marrë përsipër për të bërë. Që do të thotë në zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore, qytetarët të jenë jo vetëm votues të subjekteve, por dhe votues të kandidatëve që ata duan të jenë të përfaqësuar prej tyre në këshillat bashkiakë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kume! Nuk e di nëse zoti Kikia do të shtonte diçka meqenëse iu bashkua diskutimit, si përfaqësues i Forumit “Mendimi i Lirë”, do të donit të flisnit?!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

Z. M. Kikia: Ajo që zoti Kume referoi është padyshim gjithë konkluzioni i asaj pune që është bërë nga një grup organizatash të shoqërisë civile për të ndërhyrë dhe përmirësuar ligjin zgjedhor. Ajo që doja të theksoja është një kërkesë për ta konsideruar këtë, jo thjesht një procedurë, por si një nevojë për të forcuar demokracinë lokale, për të çuar pushtetin te vota, në mënyrë që qytetarët përmes votës të shprehin realisht vullnetin e tyre, nëpërmjet njerëzve që zgjedhin. Ndaj pa shtuar gjë nga ajo që zoti Kume theksoi, unë thjesht do të lutesha nëse do të shprehesh në këtë mënyrë, për ta konsideruar seriozisht këtë nismë, pasi nuk është thjesht një projekt për t'u përmbyllur, por është një proces që është në vazhdim e përpjekjeve të vazhdueshme të shoqërisë civile si një aktor i rëndësishëm për të përmirësuar dhe rritur standartet e demokracisë në vend. Thjesht jemi në pritje për t'u konsideruar dhe të gatshëm për të dhënë kontributin tonë edhe në vazhdim, faleminderit zoti Kryetar!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kërkesa është për tre muaj afati? Kështu e keni!?

Z. K. Kume: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord! Ne vlerësojmë se kërkesa është në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe të legjislacionit shqiptar, respektivisht të Kodit Zgjedhor, neni 19, pika 1 dhe 2, si dhe të ligjit "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë", respektivisht neni 6, pika 3, neni 10 dhe neni 13, pika 1, ndaj vendosim:

1. Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas lidhjes që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 08.04.2022*

2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të realizohet brenda një periudhe tre mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.
- Seanca mbyllet, faleminderit!

Z. K. Kume: Ju faleminderit dhe Ju!

Vendimi nr. 142

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

